



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 236 Akti

Nr. 322 Vendimi  
Tiranë, më 10.12.2020

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 10.12.2020, në mjediset e punës së Komisionit, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Bilbil Mete**, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Neni “G”** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligj nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

**Vendimi nr. 78**, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. 214, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Bilbil Mete, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.

84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), të gjithë prokurorët i nënshtrohen rivlerësimit, *ex officio*.

2. Në datën 15.11.2018 u hodh shorti në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për trupin gjykues, i cili do të kryejë procesin e rivlerësimit të subjektit Bilbil Mete. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Pamela Qirko dhe Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit dhe zgjodhën kryesues komisionerin Lulzim Hamitaj.

3. Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit administroi shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2020, të KLP-së, me të cilën përcillej vendimi nr. 214, datë 15.10.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, për prokurorin në Prokurorinë e Përgjithshme, z. Bilbil Mete, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. Sipas këtij vendimi Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbështetur në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e z. Bilbil Mete, administruar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë me nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2020, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për prokurorin Bilbil Mete. Efektet e këtij vendimi kanë filluar në datën 31.10.2020.

## II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

4. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Bilbil Mete, ka nisur në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.” Komisioni ka filluar hetimin administrativ për rivlerësimin e subjektit Bilbil Mete dhe gjatë kësaj periudhe është njohur me vendimin nr. 214, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”.

5. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, konstaton se:

a) Z. Bilbil Mete, ka qenë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

b) Këshillit të Lartë të Prokurorisë me vendimin nr.214, datë 15.10.2020, ka vendosur: (i) deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Bilbil Mete, për shkak të dorëheqjes; (ii) efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 31.10.2020; (iii) njoftimin e z. Bilbil Mete dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për këtë vendim; (iv) publikimin e vendimit në faqen zyrtare të KLP-së.

c) Subjekti rivlerësimit ka informuar Komisionin në datën 3.11.2020 se ka paraqitur ankim ndaj vendimit të KLP-së, në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, me objekt: “Ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 214, datë 15.10.2020, me të cilin është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për mua ankuesin”.

ç) Subjekti në datën 12.11.2020 ka informuar Komisionin mbi: (i) Vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ nr.\*\*\* (\*\*\*-\*\*\*-\*\*\*-\*\*\*) Regjistri Themeltar, me datë regjistrimi 3.11.2020, “Për njoftimin e kërkesëpadisë”, i cili i drejtohet të paditurit: Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe personit të tretë: Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë. Ky vendim mban datën 9.11.2020. Në dispozitivin e këtij vendimi, thuhet se, palës së paditur i është lënë një afat 10 ditor për depozitimin në sekretarinë e Gjykatës së Apelit Administrativ të prapësimeve me shkrim, si dhe akteve të plota shkresore në të cilat është bazuar nxjerrja e aktit objekt gjykimi, sipas kërkesëpadisë. (ii) Vërtetimin nr. \*\*\*, datë 10.11.2020, të lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, i cili provon se z. Bilbil Mete ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme deri në datën 31.10.2020 dhe se marrëdhëniet financiare janë

shkëputur në datën 1.11.2020. (iii) Kërkesën e datën 17.8.2020, me kërkues Bilbil Mete, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, Sektorit të Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore, Dega Tiranë, ku kërkon se nuk dëshiron të vazhdojë marrëdhëniet e punës pas mbushjes së moshës për pension dhe kërkon të ushtrojë të drejtën e daljes në pension.

6. Pika 1, e nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, përcakton: “ *Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen ... c) mbush moshën 67 vjeç ...* ”.

7. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon: “*1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.*”

8. Neni “G”, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “*1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*”

9. Në pretendimet e z. Bilbil Mete në ankimin e depozituar ndaj vendimit nr. 214, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shprehet se:

*“Pasi u njoha me vendimin e mësipërm, konstatoj se, ai është marrë në kundërshtim me të vërtetën, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe parimet e përgjithshme që normojnë veprimtarinë e organeve publike.*

*Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka mbajtur parasysh se kur magjistrati plotëson kushtet sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe shpreh vullnetin për dalje në pension, statusi i magjistratit mbetet vetëm një mbulesë e jashtme, apo një guaskë, që duhet të deklarohet se nuk ekziston. Por, sigurisht, ky deklarinim duhet të bëhet pa cënuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nga parimet e përgjithshme të shprehura qartësisht në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, etj. Këshilli me aktin administrativ individual që ka nxjerrë për mua ankuesin ka mbivlerësuar ligjin për statusin e magjistratit dhe ka nënvleftësuar, madje nuk ka përfillur aspak, ligjin për sigurimet shoqërore, ose, e thënë me fjalë të tjera, ka mbivlerësuar guaskën dhe ka injoruar thelbin, çka e bën këtë akt të papranueshëm.*

*Në kërkesën time të paraqitur përpara KLP-së në datën 25.9.2020, nuk përmendet asnjëherë fjala “dorëheqje”, sepse nga ky institucion kam kërkuar deklarinimin e ndërprerjes së mandatit të magjistratit për shkak të daljes në pension. Me ndryshimet që i janë bërë nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me ligjin nr. 48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germa “c”, e pikës 1, është bërë: “Mbush moshën 67 vjeç;”, ndërsa fjalia e parë e pikës 5 të saj është bërë: “Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç”.*

*Këto ndryshime, siç shihet qartë, kanë të bëjnë me shtimin e moshës së statusit, por jo me shtimin e moshës së pensionit. Moshë e pasjes/zotërimit të statusit deri në 67 vjeç nuk mund të kufizojë dhe të kushtëzojë moshën e daljes në pension, që me ligjin themelor të sigurimeve shoqërore ka qenë dhe është 65 vjeç.”*

10. Referuar fakteve të konstatuara më lart, sipas nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, statusi i magjistratit përfundon me mbushjen e moshës 67 vjeç (n. 64/1/c). Në ndryshimet që i janë bërë nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, bazuar edhe në vendimin nr. 34/2017, të Gjykatës Kushtetuese, moshë e pensionit të magjistratëve duhet të garantojë sigurinë ligjore dhe duhet të miratohet me shumicë të cilësuar, duke përcaktuar në ligj moshën e daljes në pension të magjistrateve 67 vjeç, ndryshim ky i bërë duke marrë parasysh edhe legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore. Ndryshimet në dispozitën e cituar më lartë synojnë të vendosin rregulla dhe procedura të qarta për përfundimin e statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kur ata mbushin moshën e pensionit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Ndryshimi i dispozitës duke zëvendësuar togfjalëshin “mbushin moshën për pension” me togfjalëshin “mbushin moshën 67 vjeç”, e lidhur kjo me mbarimin e statusit të magjistratit, e bën vendimin e KPL-së, në vlerësim të Komisionit, të drejtë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Nga dokumentet e paraqitura nga z. Bilbil Mete rezulton se aktualisht nuk ushtron më funksionin e prokurorit dhe statusi i tij ka përfunduar.

12. Akimi i bërë prej tij në Gjykatën Administrative të Apelit lidhet me shkakun e përfundimit të statusit të tij, duke iu referuar interpretimit të dispozitave në fuqi dhe të drejtës së tij për të dalë në pension në moshën 65 vjeç, çka në vlerësim të Komisionit nuk lidhet me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për këtë subjekt rivlerësimi, pasi vetë subjekti e ka njoftuar Komisionin se nuk e ushtron më këtë funksion.

13. Komisioni pyeti z. Bilbil Mete nëse ka aplikuar për të dalë në pension, ku ai u shpreh se ka aplikuar nëpërmjetë platformës e-Albania dhe duke përcjellë formatin e aplikimit online si dhe dokumentacionin përkatës.

14. Në datën 27 nëntor 2020 Komisioni ka ftuar subjektin për tu dëgjuar në një seancë dëgjimore, duke e njoftuar atë se nëse nuk e ushtron këtë të drejtë, procesi i rivlerësimit do të ndërpritet pa u zhvilluar një seancë dëgjimore.

15. Në datën 28 nëntor subjekti ka informuar Komisionin se nuk dëshiron të dëgjohet në seancën dëgjimore të caktuar nga Komisioni, duke u shprehur se, që në datën 30.10.2020 është ligjërisht pensionist.

16. Në zbatim të nenin 64, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, z. Bilbil Mete nuk ka mbushur moshën 67 vjeç dhe kjo dispozitë nuk parashikon ndërprerjen e statusit për shkak të daljes në pension, por kur magjistrati mbush moshën 67 vjeç. E drejta e çdo shtetasi për të dalë në pension është e pakufizuar por në vlerësim të kushteve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 96/2016, vlerësohet se jemi në kushtet e një ndërprerjeje për shkak se subjekti nuk dëshiron të ushtrojë më këtë funksion sipas përcaktimeve në ligjin nr. 96/2019, pavarësisht të drejtave që i burojnë atij prej ligjeve të tjera, e se ndodhemi në kushtet e nenit “G”, të Aneksit të Kushtetutës.

17. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit “G”, të Aneksit të Kushtetutës.

18. Komisioni vlerëson se vendosja e këtij kufizimi në rastin konkret gjen zbatim pasi, me daljen në pension për shkak të mbushjes së moshës 65 vjeç (si shprehje e vullnetit të vetë kërkuesit), ndërkohë që moshë e përcaktuar me ligj për ushtrimin e funksioneve të magjistratit

është 67 vjeç, po ashtu dhe ajo për ushtrimin e detyrave të tjera në organet e drejtësisë shkon deri në moshën 70 vjeç, nuk e pengon z. Bilbil Mete të aplikojë në të ardhmen për ndonjë nga pozicionet e cituara.

19. Po ashtu, Komisioni vlerëson se nuk ka shkaqe për të pritur zgjidhjen e ankimit të ushtruar nga z. Bilbil Mete në Gjykatën e Apelit Administrativ, pasi në çdo rast mbetet i pandryshuar vullneti i shprehur i subjektit për të mos ushtruar funksionin e prokurorit duke zgjedhur të dalë në pension në moshën 65 vjeç. Po ashtu, Komisioni nuk mund të vazhdojë më tej me përfundimin e procesit të rivlerësimit për këtë subjekt, për shkak të zgjedhjes së vetë subjektit për të mos e ushtruar më funksionin e tij, e duke arsyetuar se e drejta për të vendosur kufizimin sipas neni “G” të Aneksit të Kushtetutës është në kompetencë dhe vlerësim të organeve të vettingut dhe në këtë rast duhet vendosur.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G”, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenet 64 dhe 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Bilbil Mete, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë (përfunduar në datën 30.10.2020).
2. Ndalimin e emërimit të z. Bilbil Mete, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 10.12.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim Hamitaj**  
**Kryesues**

**Pamela Qirko**  
**Anëtare**

**Valbona Sanxhaktari**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*